

REZOLUTË

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, pas tragjedisë së shkaktuar si rrjedhojë e sulmeve terroriste mbi Nju Jork dhe Uashington D.C. më 11 shtator 2001, si dhe duke vlerësuar ndikimet e mundshme mbi rendin dhe sigurinë globale:

1. ndan dhimbjen dhe shpreh solidaritetin më të thellë me popullin amerikan dhe familjet e viktimave;

2. dënon ashpërsisht këto akte terroriste barbare të kryera mbi civilë të pafajshëm dhe simbolet e demokracisë dhe i konsideron ato dhunim flagrant të së drejtës më themelore të individit, të drejtën për jetën, si dhe i cilëson ato si një agresion kundër vlerave të lirisë dhe demokracisë në botë;

3. shpreh gatishmërinë dhe vendosmërinë për të mbështetur dhe bashkëpunuar me Qeverinë e SHBA-së dhe aleancën e vendeve demokratike në luftë kundër terrorizmit, për të nxjerrë përpara drejtësisë e për të ndëshkuar përgjegjësit e këtyre krimeve të përbindshme, si dhe për të çrrënjësuar shkaqet e tyre;

4. vlerëson se ky lloj terrorizmi, që nuk njeh kufij, duhet të neutralizohet mbi bazën e një zgjidhjeje komplekse globale, politike, institucionale etj. dhe të krijimit të një koalicioni ndërkombëtar efikas për këtë qëllim;

5. konsideron se akte të tilla terroriste frymëzohen nga grupe të caktuara ekstremiste, të cilat përmes një shtrembërimi të qëllimshëm të parimeve fetare për justifikimin e dhunës, synojnë të provokojnë një përplasje midis Perëndimit dhe Botës Islamike.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, nisur nga angazhimet që burojnë nga anëtarësia e Shqipërisë në organizmat ndërkombëtarë, dypalëshe dhe me organizmat euroatlantikë e të sigurisë rajonale, i kërkon Qeverisë Shqiptare të intensifikojë përpjekjet për bashkërendimin e veprimeve të të gjitha institucioneve të shtetit në luftën kundër veprimeve terroriste, krimet të organizuar dhe të gjitha llojeve të trafikeve.

Në këtë kuadër, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në bashkëpunim me Qeverinë:

-të rishikojë të gjithë kuadrin ligjor ekzistues kundër akteve terroriste, me synim parandalimin dhe goditjen e fuqishme të terrorizmit;

- të ndërmarrë të gjitha veprimet për plotësimin e procedurës së nevojshme për ratifikimin e konventave antiterroriste ekzistuese dhe, në mënyrë të veçantë, Statusin e Romës për Gjykatën Penale Ndërkombëtare dhe Marrëveshjen Ndërkombëtare për Goditjen e Financimeve të Terrorizmit.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë të monitorojë përmbushjen e detyrimeve, që rrjedhin nga të gjitha konventat ekzistuese të ratifikuara në luftën kundër terrorizmit dhe të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm për plotësimin e kuadrit ligjor në këtë drejtim, duke respektuar e zhvilluar më tej liritë dhe të drejtat e njeriut.

Tiranë, më 26.9.2001